

Rekomandime



Rekomandime



Barazia gjinore dhe gjithëpërfshirja në
vendin e punës

Rekomandime të përgjithshme



- - Institucionet përgjegjëse të angazhohen në parandalimin e stereotipeve gjinore që nga edukimi i hershëm.
- Transpozim i direktivave që mundësojnë balancimin mes jetës dhe punës dhe mbi zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit për vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor si shtete që aspirojnë anëtarësimin në BE.
- Ratifikimi i konventës së ILO – C190, për eliminimin e dhunës dhe ngacmimit në vendin e punës.



Leja prindërore

- Të miratohet ligji për lejen prindërore.
- Të zvogëlohet barra e punëdhënësit në pagesën e lejes së lindjes në atë mënyrë që: gjatë 6 muajve të parë të lejes së lindjes, 70% e pagës bazë paguhen nga Qeveria, ndërsa gjatë 3 muajve të ardhshëm 70% e pagës paguhen nga punëdhënësi, ndërsa 3 muaj të tjerë janë pa pagesë.
- Të mundësohet transferimi i lejes prindërore në mes të prindërve.
- Të sigurohet digjitalizimi i procesit të aplikimit për leje të lehonisë.



Strategjitë për trajtimin e ngacmimit dhe diskriminimit në vendin e punës



- Hartimi i politikave për secilin institucion privat e publik lidhur me ngacmimin.
- Informimi i të gjithë punëtorëve për obligimet lidhur me rregullativën e sipërtheksuar.
- Parashikimi i mekanizmave raportues dhe funksional për ngacmim brenda secilit punëdhënës.
- Institucionet përkatëse të drejtësisë të trajtojnë me prioritet rastet e ngacmimit meqë të njëjtat mund të përshkallëzohen.
- Të rriten veprimet e informimit dhe trajnimeve për secilin punëtor për format e diskriminimit, ngacmimit nga institucionet shtetërore, organizata e shoqërisë civile dhe donatorët e huaj.



- Të ipen bursa për studentet në fushat e STEM.
- Të ipen grante institucionale për start up të bizneseve të drejtuara nga gratë.
- Të hartohen dhe zbatohen politika dhe kurrikula bazuar në nevojat e tregut të punës për këshillim të karrierës që sigurojnë se ndasitë tradicionale gjinore për profesionet/fushat e studimit nuk duhet të vlejnjë.

Mbështetja e pjesëmarrjes së grave në sektorët tradicionalisht të dominuar nga meshkujt

